



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3503/1 Prot.

Tiranë, më 31.10.2023

URDHËR

Nr. 727, datë 31.10.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 997, DATË 18.6.2014 "PËR
PUBLIKIMIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË"

Në zbatim të nenit 15 dhe nenit 34 pika 2, të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, VKM nr. 330, datë 22.4.2020, "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore 'Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS'", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese:

URDHËROJ:

1. Pika 2 e Urdhrit nr.997, datë 18.6.2014, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, shtohet pika 2.1. si në vijim:
"Kërkesa e palës së interesuar, duhet të paraqitet nëpërmjet Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë dhe Interesave Privatë EACIDS. Në çdo rast, pala e interesuar akseson sistemin nëpërmjet kredencialeve të portalit qeveritar e-Albania".
2. Pika 3 e Urdhrit nr.997, datë 18.6.2014, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, ndryshon si në vijim:
"Në rast se personi i interesuar është vetë subjekti deklarues, mund të kërkojë vetëm kopje të deklarimeve të depozituara përpara se deklarimi të kryhej nëpërmjet Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë dhe Interesave Privatë EACIDS, duke i bashkëlidhur kërkesës, kopje të dokumentit të identifikimit".
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Evgjeni BASHARI

